



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština -Municipality of Prishtina

**KRYETARI I KOMUNËS**

14-011/02-43530/22, më 28. 02. 2022

Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008), nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, merr këtë

**V E N D I M**

- I. Miratohet vendimi për caktimin e komisionit për hartimin e ndryshim-plotësimit të Rregullores 01-011/02-187748/19, e dt.01.08.2019 për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës.
- II. Anëtarët e komisionit të cekur në pikën I të këtij vendimi janë:
  1. Arbër Sadiki, Drejtor në Drejtorinë e Urbanizmit;
  2. Doruntina Maloku, Drejtoreshë në Drejtorinë e Pronës;
  3. Florian Dushi, Drejtor në Drejtorinë e Inspektionit;
  4. Ilirik Musliu, Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit;
  5. Mimoza Sylejmani, Drejtoreshë në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm;
- III. Detyrë e komisionit të cekur në pikën II të këtij Vendimi, është bashkërendimi i punës dhe aktiviteteve me zyrtarët profesional të drejtorive përkatëse të Komunës së Prishtinës, për hartimin e plotësim-ndryshimit të Rregullores 01-011/02-187748/19, e dt.01.08.2019 për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës.
- IV. Për kryerjen e detyrave të cekura në pikën III të këtij Vendimi, komisioni i raporton Kryetarit të Komunës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

**I DORËZOHET:**

- Anëtarëve të Komisionit;
- Qendrës për shërbime me qytetar;
- Në dosje.

